



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ITALIANE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Morfologji e Gjuhës B

Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë mësimore; 20 leksione / 20 seminare

Viti / Semestri : Viti I, semestri II

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor – *Gjuhë, letërsi dhe qytetërim italian*

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

Adresa elektronike e titullarit/pedagogut të lëndës: adrian.haxhillazi@unitir.edu.al

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Studenti duhet të jetë i aftë të: njohë konceptet që lidhen me fjaline dhe elementët përbërës të tij (pjesët e ligjëratës); analizojë fjali të ndryshme, duke u përqëndruar në elementët përbërës të fjalisë (pjesët e ligjëratës); përzgjedhë dhe krijojë fjali të sakta në mënyrë të pavarur.

Objektivat specifike lëndore:

Studenti duhet të jetë i aftë të:

1. Të asimilojë (përthithë) konceptet kryesore të shkollave të ndryshme gjuhësore mbi Gramatikën, në mënyrë të veçantë ato që kanë të bëjnë me Morfologjinë italiane;
2. Të punojë mbi fjali të marra nga tekste të ndryshme, duke analizuar të gjithë elementët përbërës të saj (pjesët e ligjëratës);
3. Të përftojë njohuri të përgjithshme gjuhësore mbi koncepte si: pjesë e ligjëratës, normë gramatikore, gjinia, trajta, koha, veta, mënyra etj.

Lënda është e konceptuar e ndarë në leksione dhe seminare. Korpusi teorik ngërthen konceptet bazë të Morfologjisë italiane në përgjithësi dhe të lidhjes së saj me disiplina të tjera gjuhësore. Gjatë orëve të leksioneve studentëve do t'u ofrohen një sërë tematikash ku vijimësia logjike e koncepteve do të ndjekë dhe një vijimësi diskutimi në praktikë gjatë orëve të seminareve. Ky harmonizim do t'u vijë në ndihmë studentëve për të përvetësuar sa më mirë lëndën.